

Sekretari Gjeneral i Këshillit të Evropës dënon sulmet kundër Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë

Deklaratë nga Terry Davis

Strasbourg, 07.03.2007 – Dënoj fuqishëm përdhosjen e Kishës së Shën Gjonit Lajmëtarit në qytetin e Pejës në Kosovë. Kisha Ortodokse Serbe është dëmtuar gjatë trazirave të marsit 2004 dhe është rinovuar vitin e kaluar si pjesë e programit të udhëhequr nga Këshilli i Evropës. Organizata jonë ka qenë e përfshirë në restaurim sepse monumentet e dëmtuara janë pjesë e trashëgimisë së përbashkët evropiane. Rindërtimi është kryer nga punëtorët e të gjitha komuniteteve etnike që jetojnë në Kosovë dhe me këtë kanë riformuar pronësinë e përbashkët dhe prospektin e pajtimit.

Ata që i kthehen dhunës rrezikojnë të ardhmen e të gjithëve që jetojnë në Kosovë. E ardhmja është më shumë se sa statusi. Ajo përcaktohet nga kualiteti i jetës, e jo nga sasia e kufijve. Nëse njerëzit e Kosovës nuk gjejnë fuqinë që të lirojnë vetën nga shtrëngimi i dhunës dhe urrejtjes etnike, atëherë Kosova do të bëhet një burg për shumicën dhe pakicat njëqytet, pa marrë parasysh se çka do të vendosë Këshilli i Sigurimit i KB-ve.

Njësia e Shtypit e Këshillit të Evropës

Tel: +33 (0)3 88 41 25 60

Fax: +33 (0)3 88 41 39 11

pressunit@coe.int

www.coe.int/press